

**Albana DEDA (NDOJA)**

## **KOKA FJALËFORMUESE DHE TIPOLOGJI ANALIZE TË KORPUSIT FJALËFORMUES**

### **Hyrje**

Fjalëformimi është ai nivel studimi, i cili ka qenë dhe mbetet problematik në studimet tona, por jo vetëm. Kjo që në fillimet e studimit të tij e akoma dhe sot. Dihet se ai është studiuar në kuadrin e morfologjisë tradicionale. Një gjë të tillë e dallon edhe Plag, pasi e përcakton si pjesë të studimit të morfologjisë bashkë me fleksionin (Plag, 2002:22). Kujtojmë gjithsesi se në nivelet e studimit gjenerativ ai lihet jashtë (fjalëformimi) dhe shihet si nivel studimi më vete.

Në një artikull tonin të mbajtur në një konferencë mbi kontributin e prof. Eqrem Çabejt para shumë viteve, duke prezantuar për herë të parë në studimet tona në këtë fushë konceptin e kokës fjalëformuese (manualët e asaj konference nuk u botuan), ne kemi vënë në dukje dhe problematikat që vihen re në studimet tona dhe të cilat nuk kanë ndonjë ndryshim thelbësor në trajtim fatkeqësisht, që atëherë.

Problematikat në fjalëformim janë pohuar dhe nga studiuesit tanë. Kështu Çabej & Xhuvani janë shprehur se *“Konstatimi i këtyre (parashtesave) paraqitet në gjuhën tonë më i vështirë se sa i prapashtesave. Vetë fakti që sidomos në fushë të shqipes kufijtë mes parashtesimit dhe përngjitjes nuk janë përherë të prera e bën më të vështirë veçimin e këtyre elementeve formativë nga fjalët bazë që janë formuar me to.”* (Çabej & Xhuvani, 1987:49).

Shaban Demiraj do t'i shihte përngjitjet si pjesë të kompozitave të morfologjia e hartuar prej tij (Sh. Demiraj, 1967:1).

Dhjetë vjet më vonë A. Kostallari formuloi disa kriteret për dallimin e përngjitjes nga kompozimi. Në këtë artikull ai do të pohonte se: “*Fjalët e përbëra dhe fjalët e bashkangjitura nuk mund të shkëputen fare nga njëra tjetra. Ato kanë disa tipare që i afrojnë. Në radhë të parë ato kanë lidhje gjenetike. Studiuesit e gjuhësisë së krahasuar kanë arritur në përfundimin se gjenetiksht kompozitat e kanë burimin të togfjalëshat të cilët me zhvillimin e gjuhës kanë pësuar ndryshime të shumëllojshme fonetike, morfologjike e semantike.*” (A. Kostallari, 1976, nr 2:9).

Enver Hysa, duke folur për problemin e kufijve fjalëformues, ripohonte edhe një herë problemet mes parashtesimit e përngjitjes, apo parashtesimit, përngjitjes dhe të disa tipave të përziera (E. Hysa, 2004:43).

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe* theksohet fakti se parashtesimi është zhvilluar në lidhje të ngushtë me kompozimin dhe përngjitjen. Po kështu, pasi jepen dallimet mes përngjitjes dhe kompozimit, pohohet ideja e Kostallarit për prejardhjen e përbashkët historike (Gramatika, 2002: 66-72).

Duke parë boshllëkun e këtyre studimeve, prof. J. Thomai me të drejtë do të pohonte: “*Me gjithë këto në studimet e lartpërmendura nuk tregohet se ç’forcë modifikuese ka ndajshitesa.*” (J. Thomai, Sf:1983).

Në vazhdim të këtyre vëzhgimeve mund të themi se jo rrallë konstatohen probleme në kanalizimin e sindajshitesave (Edhe vetë si term nuk na duket i rregullt, se në fund të fundit jep një tendencë, por nuk përcakton saktë kalimin në ndajshitesë. Ai diskutohet te kompozimi në *Gramatikën I*. Aty gjithsesi nuk jepen kriteret e sakta se kur mbaron procesi i kalimit në ndajshitesë.). Fjalëformimi pa ndajshitesë si rast i një fjalëformimi të tipit morfologjik, në krahasim me konversionin (që është tip fjalëformimi jomorfologjik) është një rast tjetër interesant, pasi në fakt të dyja identifikohen gjatë një procesi analize distributive sintaksore.

Shumë vështirësi hasen në përcaktimin e saktë të llojeve të tipave të përzier. Lokucionet nuk diskutohen fare nga pikëpamja fjalëformuese.

Në raste të tjera p.sh. megjithëse pohohet se “*Formant quhet mjeti fjalëformues dhe kuptimi tij në një fjalë të dhënë në një temë jo të parme.*” (Gramatika I, 2002:55), gjatë analizës fjalëformuese rol kryesor luan kuptimi i temës fjalëformuese, e cila duhet të ketë ngjashmëri kuptimore të pjesshme, me temën e re, ndërsa në lidhje me kuptimet plotësuese të ndajshesave nuk shtrohen shumë për diskutim. Mbi të gjitha nuk sistematizohen edhe të dhënat e mbledhura në rregulla fjalëformuese që pasqyrojnë si pasuritë semantike, ashtu dhe produktivitetin e formanteve apo dhe temave fjalëformuese. Në këtë kuadër nuk identifikohen edhe kufizimet përkatëse.

Duhet shtuar se praktikisht edhe ky proces i sugjeruar analize bie dhe reduktohet vetëm në gjetje afiksesh dhe temash fjalëformuese, që janë lidhur me njëra -tjetrën në kuadrin e një analize morfemore, e cila gjithashtu shfaqet e mangët dhe jo gjithëpërfshirëse, pasi ka probleme në përcaktimin teorik të konceptit të morfemës (për të cilin do të flasim më poshtë). Ky pohim është lehtësisht i verifikueshëm, nëse shohim edhe ushtrimet në tekstet parauniversitare (Filara - kl. VII, Pegi - kl. VII, Albas - kl. VII).

Pas pohimeve të mësipërme (dhe jo vetëm), analiza e fakteve na bën të mendojmë që problemi ndoshta duhet parë dhe nga këndvështrime të tjera e jo vetëm nga ai i gramatikës tradicionale.

### **Metodologjia e punës**

Në fillim të këtij punimi do të rimarrim edhe një herë konceptin e kokës fjalëformuese, duke e zgjeruar tashmë edhe me trajtime të tjera. Kështu, fillimisht jepet në mënyrë analitike koncepti i kokës si term i huazuar nga sintaksa, duke trajtuar në hollësi problematikat e kritereve të tij në rrafsh morfologjik. Jepet trajtimi gjenerativ mbi kokën, paraqitjen skematike të tij të ilustruar me shembuj të shqipes. Në vijim do të trajtohen dy qasje metodologjike drejt studimit të korpusit fjalëformues që e kanë të detyrueshëm njohjen e konceptit të mësipërm. Bëhet

fjalë për qasjen që përcakton rregullat me bazë morfemën (morpheme -based morphology, për të cilën është folur më sipër dhe që pjesërisht është aplikuar edhe në gramatikën tradicionale) dhe rregullat me bazë fjalën (word- based morphology). Në punim do të diskutohet mbi koncepte terminologjike të përdorura dhe në studimet tona dhe si konceptohen ato në dy qasjet e përshkruara. Në fund do të jepen sugjerime mbi përdorimin e metodës më me avantazh në korpusin e shqipes. Trajtimi pra do të këtë karakter analitik, krahasues e në fund sugjerues.

### **Literaturë e përdorur**

Gjatë kësaj pune, në lidhje me studimet tona në aspektin fjalëformues, kemi konsultuar punimet e Çabejt e Xhuvanit mbi “Parashtesat dhe prapashtesat e shqipes” (Prishtinë:1987), Shaban Demirajt (Morfologjia:1967), Enver Hysës (Fjalëfomimi i emrave :2004), Androkli Kostallarit (Sf:1976), si dhe Gramatikën e gjuhës shqipe I (2002) etj.

Në lidhje me konceptin e kokës fjalëformuese dhe dy qasjeve të sugjeruara nga studiuesit e huaj kemi konsultuar: Bloomfield (1935); Bauer (1983, 1989, 1990); Aronoff (1976); Selkirk (1982); Williams (1981); Guersel (1983); Di Schiullo & Williams-it (1987); Lieber (1981); Baker (1988); Carstairs-Mc Carthy (1992); Plag (2002) etj.

Në lidhje me konceptet morfologji me bazë morfemën (morpheme -based morphology) dhe morfologjia me bazë fjalën (word- based morphology) janë konsultuar Aronoff (1976), Plag (2002) dhe Akcema (2007).

### **Koncepti i kokës**

Konceptin e kokës e gjejmë të lidhur fillimisht në gramatikë me rrafshin sintaksor te Bloomfield-i, i cili e përcaktonte atë *si elementin e detyrueshëm dhe që ka të njëjtin distribucion të gjithë strukturës së ndërtimit endocentric* (Bloomfield:1935, kur bënte dallimin mes strukturave endocentrike dhe ekzocentrike).

Bauer-i (1990:2) përmbledh trajtimet dhe diskutimet e bëra në lidhje me këtë koncept më vonë nga Zickey (1985) dhe

Hudson-i (1987), si dhe të artikujve të saj pararendës, duke na dhënë këto kritere për këtë koncept:

- Semantikisht një sintagmë është një hiponim i kokës së saj. Referenca e termit është Hudson (1980), i cili e përcakton hiponiminë si një marrëdhënie paradigmatiche e kuptimit, referencës (A.D.) së tij, një lloj transportimi semantik nëpërmjet disa modifikimeve sintagmatike të leksemës së mbivendosur p.sh. *blej* është hiponim i *marr*, *miqësor* është hiponim i *këndshëm* (ka ngjashmëri me një lloj referimi metonimik të pjesshëm kuptimor. A.D.).

- Koka e sintagmës është subkategorizuesi (pra indukon tiparet kategoriale të saj dhe përfaqëson gjithë grupin me to, pavarësisht nga zgjerimi a ngushtimi i grupit).

- Koka e frazës përçon të dhëna morfo-sintaksore në gjithë ndërtimin (Në këtë mënyrë indukon kompozicionin morfosintaksor brenda frazës. A.D.).

- Koka është drejtuesi (governer), pra përcakton format morfologjike të disa njësive të tjera të varura nga ajo nga pikëpamja e përshtatjeve morfologjike;

- Koka drejtuese është ekuivalenti distribucional i gjithë sintagmës (Pra në fund të fundit ajo projektton dhe projektimin distribucional të gjithë grupit. Ajo që vinte re Bloomfield dhe që ka të bëjë me projektimin semantiko-sintaksor të saj në të gjithë fjalinë.);

- Koka e sintagmës është konsituent i detyrueshëm i saj (nuk mund të ketë frazë pa kokë).

Në lidhje me këto kritere (dhe ndonjë tjetër) natyrisht ka pasur edhe kritika. Në një artikull prej 32 faqesh Bauer-i (1990), pasi sheh realizimin apo mosrealizimin e të gjitha këtyre kritereve të prefikset, sufikset, madje edhe mjetet flektive të anglishtes, në mënyrë statistikore vëren se tendenca për ta përcaktuar konceptin e kokës edhe në fjalëformim apo në fleksion, nëpërmjet këtyre kritereve të huazuara nga sintaksa paraqitet i vështirë dhe jo përgjithësues (Bauer, 1990:20), duke pranuar gjithsesi se *detyrueshmëria dhe karakterizimi kategorial* mund të jenë dy kritere të qëndrueshme në morfologji edhe sipas Anderson dhe Ewen (1987:80).

Realiteti i përcaktimit të kokës sot pas kaq kohësh, kur është përcaktuar të paktën nga gjenerativistët me kohë se koka përfaqësohet me rregullat e anës së djathtë (Right Hand Rule) dhe tashmë është aplikuar si koncept [kujtojmë që edhe Bauer-i në fund të artikullit të saj nuk e mohon domosdoshmërinë e këtij termi, qoftë edhe duke u justifikuar se *mbase realiteti i korpusit të hulumtuar nga ajo vlen vetëm për anglishten e ndoshta për kodet e tjera nuk shfaq problemet e parashtruara nga ajo* (Bauer, 1990:31)], nuk vihet në diskutim, të paktën në manualet që lidhen me fjalëformimin (Plag: 2002).

Atëherë pse qenka ky koncept edhe në morfologji, duke përfshirë këtu jo vetëm fjalëformimin, po dhe fleksionin?

Argumentet që jepen në lidhje me këtë pyetje janë jo ta pakta, të tilla si:

- Për të shmangur disa pamjaftueshmëri të rregullave me në bazë konsituentet, të cilat nuk e dallojnë kokën. Më konkretisht ky koncept, sipas tyre shfaq natyrën e marrëdhënieve të strukturës së thellë dhe gjithë raportet që kanë në bazë marrëdhëniet mes konstituenteve (Anderson, 1971: 28-29).

- Për të lejuar dhe formalizuar kalimin e të dhënave kategoriale të kokës te njësitë e tjera të varura nga ajo (Bauer, 1990:21).

- Si kërkesë terminologjike për t'iu referuar konstituentës së detyrueshme (Robinson, 1970:259-260).

- Për të thjeshtuar komponentin gjenerues-tranformacional të një gramatike (Robinson, 1970).

- Për të hequr paralele mes sintagmave të ndryshme (Mathews, 1981:166; Chomsky, 1970). Në kontekstin morfologjik mes stereotipave fjalëformuese të ndryshme.

- Për të bërë përgjithësime në lidhje me projektimin e kokës / modifikuesit në gjuhë të ndryshme (Hudson, 1980:183). Në fjalëformim do të kishte të bënte me raportet kokë-bazë, kokë-rrënjë, afiks-kokë, afiks-rrënjë etj.

- Për të shpjeguar se pse në disa gjuhë modifikuesit lëvizin bashkë me kokat (Hudson, 1980:184).

Me të drejtë Bauer-i vëren se disa prej këtyre arsyeve kanë të bëjnë më shumë me marrëdhëniet e varësisë se raporti mes konstituenteve, ku koka supozohet se është ajo e detyrueshmja (Bauer, 1990:22).

Megjithatë ajo sqaron se dy elementet e nevojshme në analizë dhe me bazë në këtë diskutim në nivelin morfologjik:

1. rregulla që ka të bëjë me *perkolacionin* ose transferimin e të dhënave kategoriale gramatikore e projeksioneve sintaksore;

2. pohimet që kanë të bëjë me renditjen (listimin) e kokave dhe modifikuesve.

Në këtë kontekst diskutimi, pasi kemi konsultuar dhe autorë të tjerë si Plag (2002), (Akcema 2007) etj., në këtë punim kemi vendosur të mbajmë qëndrimin që gjejmë në shumicën e manualeve universitare, të cilat pranojnë konceptin e kokës edhe në morfologji, e përkatësisht në fjalëformim.

### **Koncepti gjenerativ i kokës**

Në lidhje me konceptin e kokës i jemi referuar Selkirk-ut, e cila propozoi një ndarje të re, duke dalluar W-Syntax (Word syntax) ose morfologjinë dhe S-Syntax ose sintaksën e vërtetë. Në të njëjtën kohë ajo theksonte se: “*struktura e fjalës ka të njëjtat pasuri formale të përgjithshme si struktura sintaksore dhe, për më tepër, ajo gjeneron nga i njëjti lloj sistemi rregullash*” (Selkirk :1982).

Rregullat morfologjike (W-sintactic) të Selkirkut ngjanin me rregullat sintaksore (S-sintactic) për dy arsye:

**-të dyja ishin rregulla rishkruese jashtë kontekstit;**

**-të dyja vinin në përdorim kategori të ashtuquajtura të mëdha, siç janë emri, folja, mbiemri, ndajfolja;**

Për të parë se çfarë koncepti kishin gjenerativistët për fjalën, si njësinë bazë nga e cila do të niste analiza, po i referohemi Di Schiullo-s & Williams-it, të cilët në monografinë e tyre “*Mbi përcaktimin e fjalës*” (1987) bëjnë një përpjekje të madhe për të sqaruar dhe përcaktuar çështjet kryesore të përfshira në ndërtimin e një teorie të morfologjisë dhe përcaktimin e marrëdhënies së saj me sintaksën. Ndër të tjera

ata dallojnë tre nocione të përcaktuara që gjuhëtarët kanë në kokë kur flasin për nocionin “fjalë”.

a) Listemën e cila sipas tyre nënkupton një njësi të gjuhës që është, të paktën pjesërisht, idiosinkretike në të dhënat ose kuptimin e saj dhe prandaj nuk mund të shpërbëhet plotësisht në pjesë (Baker, 1988:259). Më mirë ajo mund të memorizohet dhe të ruhet në leksikonin mendor (A. Carstairs-McCarthy, 1992:11).

b) Objektin morfologjik. Ky është domeni pikërisht i morfologjisë, ku objektet morfologjike janë elemente të karakterizuara nga një sistem gjenerues rregullash, në të cilin apostrofët (primes) janë prefikset dhe sufikset, temat dhe rrënjët e një gjuhe të dhënë;

c) Atomin sintaksor (The Syntactic Atom), e cili shihet si njësi më e vogël e analizuar nga sintaksa (Di Sciullo & Williams: 1987);

E vënë brenda një kornize të tillë, te fjala filluan të studioheshin ato që u quajtën rregulla të fjalëformimit (Word Formation Rules), për përcaktimin e të cilave u vunë në punë koncepte të ndryshme (të tilla si ai i kokës, jo-kokës, strukturës binare të çdo njeje fjalëformuese, teoria e perkolacionit, parimi i pasqyrës, hipoteza leksikore, afërsia (adiacency), rregullën e anës së djathtë (Right Hand Rule), rregullën “është një”, hipotezën mbi bazën unike etj. U hartuan rregullat rirregulluese morfologjike dhe fonologjike e shumë elemente të tjera specifike për gjuhë të caktuara.).

Tre gjuhëtarët kryesorë që u morën më shumë me përcaktimin e nocionit kokë në morfologji janë Lieber (1981), Williams (1981) dhe Selkirk (1982), të cilët dhanë dhe përcaktimet të tilla si: *Sufikset derivacionale janë koka; parashtesat nuk janë koka, me disa përjashtime; disa morfema flektive mund të jenë koka; tek përbërjet koka pozicionohet në të djathtë. Të njëjtën rregull e përgjithësojmë dhe për strukturat e tjera derivacionale* (Williams :1981).

Në morfologji në përgjithësi thuhet se ***koka e një ndërtimi është ai element që përcakton kategorinë së cilës i përket e gjithë fjala*** (Scalise, 1994:12).

Sipas kësaj ideje, në një njësi leksikore si [*puno*] baza (tema fjalëformuese) është një emër, por e gjithë fjala është një folje, prandaj koka e saj është sufiksi *-o*, i cili në këtë rast përcakton kategorinë leksikore të të gjithë njësisë (duke e pajisur me kategoritë e numrit, vetës, kohës, mënyrës), dhe e modifikon atë nga ana semantike, pasi ai i përçon konstituentës së madhe nëpërmjet perkolacionit të dhëna që kanë të bëjnë me hyrje të caktuara leksikore si [+veprim] etj.

1. [[*punë*]E +o]F

Siç është vënë re dhe në punimet Aronoff-it 1976, Williams-it (1981) apo Guersel-it (1983), “*Afikse të ndryshme mund të jenë ndjeshme ndaj kokave që janë afikse të temës ose dhe afikseve të tjera të bazës p.sh. në anglisht ata marrin shembull afiksin -able që lidhet me temat latine dhe i cili në mënyrë produktive jep emra me sufiksin -ity*” (Akçema, 1988:123). Në fakt pohime të ngjashme gjejmë edhe në studimet tona, megjithëse janë sporadike dhe komplet jashtë këtij diskutimi. E kemi fjalën për diskutimin në lidhje me alomorfet fjalëformuese *sh-/zh-/ç-* që kushtëzohen fonetikiqist nga tingulli takues i temës fjalëformuese (*shthur*, *zhvidhos*, *çarmatos*) [Gramatika:45].

Duke iu kthyer nocionit gjenerativist të kokës, pranohet fakti se ajo qëndron përherë në pozicionin e djathtë të fjalës (Kjo quhet dhe rregulla e anës së djathtë (Right Hand Rule), megjithëse ka dhe raste specifike që çuan më vonë në kodifikimin e termit jo-kokë ose pranimin e rasteve përjashtimore apo të strukturave të caktuara të cilat mbeteshin në filtra të caktuar me klasifikimin [-Lexical Insertion].).

Në këtë teori pohohet gjithashtu se zakonisht sufikset kanë prirje të jenë koka, pasi ato në shumicën e ndërtimeve ndryshojnë kategorinë e fjalës bazë, ndërsa prefikset jo (Fakt ky i pohuar dhe në gramatikën tonë: “*Prapashtesat kanë një funksion klasifikues, d.m.th ato bashkë me kuptimin e ri që i japin temës së cilës i ngjiten, përcaktojnë edhe pjesën e ligjëratës ku hyn fjala e re*. [Gramatika :64]; *Parashtesa nuk ia ndryshon kategorinë gramatikore njësisë me të cilën lidhet*. [Gramatika:61]). Megjithatë këto pohime nuk shfaqin tipare të

tjera që kanë prefikset dhe sufikse të tilla, si: A mund të jenë të gjithë sufikset koka dhe a nuk mund të jenë të gjithë prefikset koka? (Kemi parasysh shembuj të tillë ku dhe prefiksi ndryshon kategorinë gramatikore të bazës me të cilën lidhet: *përbalt*, *përkrah*, *përball* etj.).

Po kështu nuk sqarohen edhe arsyet pse ndodh kjo. Nuk përshkruhen saktësisht llojet e kokave me të cilat mund të lidhet një afiks i caktuar dhe vlerat modifikuese të tij si nga pikëpamja semantike, apo dhe kategoriale.

Gjatë shtjellimit të konceptit në rrafsh gjenerativ, siç përmendëm më lart, u formulua dhe nocioni *i perkolacionit*, shumë i rëndësishëm ky. Ai shihet si proces nëpërmjet, të cilit kategoria leksikore (emër, mbiemër, folje etj.) dhe të dhënat kategorizuese semantike dhe morfosintaksore (përbërësit kategorialë konkretë; **për emrin**: femërore / mashkullore etj.; **për foljen**: e rregullt; e zgjedhueshme dhe kategoritë përkatëse etj.), të cilat i transferohen nyjës superiore të një ndërtimi morfologjikisht kompleks (Scalise, 1994:113).

Në një njësi leksikore si *ripunoj* analiza do të ishte e tillë:

2. [ri F+[[punë E] +o]F]]

Koka në shkallën e parë të analizës do të jetë prapashtesa -o, sepse të dhëna të tilla si e rregullt, transitive, koha, veta, numri përcillen drejtpërdrejt nëpërmjet perkolacionit te njësia superiore *ripuno*.

Në shkallën e dytë koka është pikërisht njësia leksikore *puno*, pasi prefiksi *ri-* nuk përcjell informacione të reja në lidhje me nyjën superiore. Perkolacioni (kalimi) i tipareve përmes kokave bën të mundur formulimin e një detyrimi morfologjik që Williams -i e quan Kushti i Atomit (Atom Condition, Williams, 1981).

Nga ana tjetër, sufiksi pozicionohet në të djathtë, ndërsa prefiksi në të majtë, që do të thotë se sufiksi plotëson dhe Rregullën e Anës së Djathtë.

Ky është një shembull shumë klasik, sepse jo rrallë hasen raste ku njësia që ka të dhënat më të ngjashme me komponenten kryesore mund të jetë dhe në të majtë. Në shqipe ky rast do të

lidhej me *përball*, *përbuz*, *përdor*, *përkrah*, *përgjunj*, *përshtat*, *përmend*, *çmend* etj. (Gramatika, 2002).

[për F+[ballë E]]

Në një hulli të tillë u studiuuan koka e fjalës si prefiks, sufiks, tek fjalët e përbëra. U bë ndarja mes kokës leksikore dhe asaj sintaksore. U fut koncepti i adiacencës (adiacenza-afërsisë). U përcaktua struktura pemë që mbështetej në diagrame binare. Hipoteza e bazës unike (UBH, Aronoff, 1976) u bë klasifikuese, u përcaktuan rregullat e derivacionit dhe të përbërjes, marrëdhëniet mes tyre dhe fleksionit, duke kaluar në raste specifike për çdo gjuhë.

Natyrisht, duke u induktuar praktikisht në çdo gjuhë, shihen dhe rastet e shmangies nga rregullat e përgjithshme e, kur ato janë redondante, kalohet dhe në përgjithësime.

### **Shqipja dhe paraqitja skematike e procesit fjalëformues**

Analiza fjalëformuese në studimet tona në parim paraqitet si një identifikim morfemash më së shumti. Procesi përshkruhet si i tillë: “*Analiza fjalëformuese ka për detyrë të zbulojë mënyrën e bashkimit të morfemave që përbëjnë një fjalë me një temë jo të parme, të sqarojë sistemin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve që kanë ato midis tyre.*” (Gramatika :53).

Pra, sipas këtij pohimi, kjo analizë lë jashtë konversionin, kompozitën, përngjitjen dhe lokucionet (idiomat) etj., të cilat nuk mund të konceptohen si bashkim i thjeshtë morfemash tradicionale (Konversioni nuk ka morfemë. Kujtojmë se në Gramatikë flitet për mbaresë 0 dhe prapashtesën trajtëformuese 0, pra në kuadrin e fleksionit, po jo të fjalëformimit. [Gramatika:48]).

Në lidhje me analizën morfemore gjejmë edhe këtë pohim: “*Si rregull për përcaktimin e kufijve të morfemave duhen gjetur shembuj me ndryshim minimal në formë dhe me një ndryshim të pjesshëm në kuptim.*” (Gramatika, 2002:50).

Sipas këtij pohimi, një proces i tillë duhet të kryhet gjatë krahasimit “*të shembujve*”, një fjalë që nuk sqarohet, nëse i referohet morfemës a fjalës, po nga shembujt dallon se ka kaluar te fjala (*padrejtësisht, padrejtësi, i drejtë* [Gramatika: 50]).

Edhe përcaktimi në lidhje me llojin e kuptimit të pjesshëm, është i mjegullt dhe i pasqaruar saktë, gjë që krijon probleme në identifikim.

Nëse i referohemi analizës dhe veçanërisht paraqitjes së saj skematike, gjejmë përsëri identifikim formal morfemash [*vul+os* (Gramatika:63); *gjith+motnë* (Gramatika:75)], pa asnjë të dhënë, semantike, apo të dhëna në lidhje me konsistencën e modelit ose produktivitetit të saj, në mënyrë që të përgjithësohet si i tillë.

Në raste të tjera nuk ka paraqitje skematike fare, vetëm identifikohet tipi i fjalëformimit.

Nga ky parashtrim mund të themi se një trajtim i tillë edhe nga pikëpamja tradicionale nuk përgjithëson gjithë modelet e fjalëformimit, duke lënë jashtë konversionin dhe fjalëformimin pa ndajshesë, rastin e idiomave (lokucioneve) apo dhe fjalëformimin prapavajtës.

I çuditshëm shfaqet edhe trajtimi i nyjzimit, i cili shihet si rast i veçantë, pavarësisht se realisht ajo (nyja) trajtohet si morfemë fjalëformuese (edhe trajtëformuese) [Gramatika:48-49].

Po kështu, problem është edhe për shkurtesat (akronimet) dhe rëniet e morfemave me vlerë fjalëformuese (P.sh. OKB dihet se është bashkimi i tre fjalëve që në fakt funksionojnë si një e vetme vetëm grafikisht; te fjala *punim* që ka këtë skemë [[[*punë E*] +*o F*] +*im E*]), në analizën tradicionale morfemore nuk dallohet prapashtesa *-o-*, pasi do të ndahej kështu *pun/im*.)

Kompozitën e përngjitjen i ndajnë më vete, pasi ato formohen nga tema, tradicionalisht fjalë, pavarësisht se po në këtë gramatikë pranohet se morfema mund të jetë edhe fjalë (Gramatika: 44).

Gjithashtu bëhet dallimi morfemë fjalëformuese dhe temë fjalëformuese (rastet e *pa-* si parashtesë *i pakënaqur* dhe *pa* si parafjalë e përngjitjes te rasti i përzier *i papunë*), pavarësisht se më lart pamë se procesi është përkufizuar si bashkim morfemash.

Nga këto parashtrime mund të konstatohet se në fakt trajtimi i procesit tregon që, pavarësisht se rezultati është identifikim morfemash, përsëri ai nuk është reduktuar vetëm te

kjo njësi, sipas konceptit tradicional, por ka kaluar edhe te fjala. Shfaqet një parregullsi në terminologji e paqartësi në proces, duke i lënë vend hamendësimit e identifikimit mekanik.

Nuk kemi rregulla të mirëpërcaktuara, qoftë edhe për njësitë që janë dalluar si morfema fjalëformuese, në të cilat të jepen edhe kufizimet përkatëse.

Sqarojmë se koncepti aktual mbi morfemën dhe fjalën ndryshon nga ai që është përdorur në studimet tona dhe ato gjenerative e jo vetëm, pasi morfema nuk është vetëm njësia më e vogël me kuptim (Gramatika, 2002: 4-33), pavarësisht se dhe Plag-u me këtë koncept e prezanton në fillim. Ajo sot në literaturën e bashkëkohore del e karakterizuar edhe nga pikëpamja fonetike, semantike dhe kufizimet që krijohen gjatë bashkimit me baza të caktuara ([Plag, 2002:39].

Po kështu edhe për fjalën jepen tipare të tilla, si: fjalët si pjesë ligjërare; fjalët si atome sintaksore; fjalët me tipare fonetike të caktuara si p.sh. ato të cilat zakonisht kanë një theks të vetëm; fjalët që zakonisht janë njësi të pandashme etj. [Plag, 2002:25]).

Gjithsesi Plag-u sqaron se jo çdo model fjalëformimi vjen si rezultat i ngjitjes ose i lidhjes së morfemave, duke na sjellë shembullin e idiomave apo afikseve që dalin me kuptime të ndryshme dhe në lidhje me baza (tema fjalëformuese) të ndryshme (më poshtë do të shohim: *përball*, *përpuñoj*).

Edhe emërtimi i procesit fjalëformues te prejardhja lidhet vetëm me formantin fjalëformuese te prejardhja dhe nyjzimi (parashtesim, prapashtesim, nyjzizim).

Duhet të shtojmë se gjithsesi, kur përshkruhen formante të tilla si parashtesa dhe prapashtesa si pjesë e fjalëformimit të klasave të fjalëve të caktuara jepen edhe karakterizime semantike për to, po në aspektin fillestar të identifikimit të tyre procesi paraqitet komplet mekanik (p.sh. “*Me prapashtesën -im formohen emra veprimi të gjinisë mashkullore.*” (Gramatika, 2002:140), “*Me prapashtesën -ar formohen kryesisht emra profesioni prej temash emërore.*” Gramatika, 2002:134).

Po kështu, analiza që lidhet me nivelin semantik të njësisë së marrë në analizë më së shumti i referohet temës

fjalëformuese të saj dhe shumë pak ose aspak formanteve fjalëformuese.

Mund të pohojmë se realisht rregulla fjalëformuese, të cilat prezantojnë njësinë jo të parme (komplekse) si njësi leksikore me të dhëna të caktuara morfosintaksore dhe mënyrën e formimit të saj në varësi të kokave të caktuara fjalëformuese, duke parashikuar dhe kufizimet përkatëse në varësi të lidhjeve me baza të caktuara (kur koka është afiks, ose edhe kur koka është një bazë) dhe arsyet e këtyre kufizimeve mungojnë në studimet tona.

Në këtë kontekst, analiza që paraqitet nga teoria që përcakton kokën si njësi fjalëformuese paraqet rregulla fjalëformuese që përcaktohen, pasi studiohen bazat me të cilën një afiks lidhet, pasuritë semantike që përçon ose i përçohen, kur nuk është kokë dhe natyrisht, duke dalluar edhe kufizimet përkatëse. Ne po japim një shembull në lidhje me parashtesën *për-*, edhe kur është pjesë e një fjale komplekse që ka kokë një bazë të caktuar (*përpunoj*, *përshkruaj*, *përzë*), edhe kur është kokë (*përball*, *përbuz*, *përdor*, *përkrash*, *përgjunj*, *përshatat*, *përmend*):

Rregulla fjalëformuese 1 [për -]

Niveli fonologjik: /për/-X

Baza X=F (*përshkruaj*, *përpunoj*)

Semantika “puno më tej”

Kufizimet: fjalët komplekse, në të cilat baza është një emër; kuptimi i veprimt<sup>1</sup> (përdor, FGjSh)

Rregulla fjalëformuese 2 [për -]

Niveli fonologjik: /për/-X

Baza X=E (*përkrash*, *përball*, *përbuz*)

Semantika “qëndrim i caktuar ndaj një [+frymor; +njerëzor]”

Kufizimet: bëj diçka më tej, në mënyrë më të thelluar (*përpuno*, *përshkruaj* FGjSh)

---

<sup>1</sup> Natyrisht që mund të ketë diskutime në lidhje me përcaktimin semantik, pasi nuk pretendojmë të kemi studiuar të gjitha rastet e modeleve fjalëformuese të njësisë në fjalë.

Siç mund të shihet nga skemat e mësipërme, kemi një përshkrim shumë të detajuar të nivelit semantik, fonologjik dhe morfologjik (e bashkë me të edhe një pjesë e nivelit sintaksor).

Po kështu procesi nuk identifikon thjesht morfema, po jep edhe vlerat semantike drejtuese të tyre, si dhe raportin e tij me bazën. Kjo lloj skeme integron edhe fjalën tashmë në proces. Pra kemi kaluar nga koncepti i morfemës te fjala.

Gjithashtu për çdo rregull jepen edhe kufizimet përkatëse, të cilat parashikojnë edhe rregullat e tjera për të njëjtën njësi (**për-** në rastin tonë).

Duhet të shtojmë se ne nuk kemi dhënë këtu të gjitha rregullat fjalëformuese të njësisë [**për-**].

**Procesi me bazë morfemën (morpheme-based morphology) dhe procesi me bazë fjalën (word-based morphology)**

Parashtrimi i problematikave të mësipërme që krijohen nga konceptimi i procesit si identifikim morfemash në fakt është dalluar edhe për anglishten. Kujtojmë sqarimet e Plag-ut për dallimin përmes këtij koncepti të konversionit, morfemës 0, shkurtesave, rënieve (fshirjeve - deletion) të morfemave që krijojnë (Plag, 2002: 27-33).

Duke parë këto problematika, Aronoff vuri në dukje se “*në teorinë gjenerative afikset nuk janë njësi të pavarura dhe nuk kanë hyrje në leksikon, kurse fjalët po. Dhe ajo që është analizuar si morfemë konstituente në morfologjinë e bazuar në morfemë (morpheme-based morphology) është conceptualizuar si një ngjashmëri fonetike dhe semantike mes kompletit, setit (me terminologjinë tradicionale fjalës së marrë në analizë dhe temave fjalëformuese të saj) të fjalëve në morfologjinë e bazuar në fjalë (word-based morphology)*” (Aronoff: 1976).


Plag shton se “*në këtë mënyrë morfologjia shpreh marrëdhëniet mes fjalëve të lidhura morfologjikisht jo duke i ndarë fjalët në komponente, po duke formalizuar tiparet e zakonshme të setit të fjalëve, p.sh. marrëdhëniet mes fjalëve bazë (temave fjalëformuese me termat tradicionalë) dhe fjalëve të derivuara prej tyre*”. (Plag: 236-237).

Skematikisht në të paraqiten të dhëna të tilla si (trajtimi më lart):

- baza ortografike (si njësi e marrë në analizë) <X>
- forma fonologjike /X/
- të dhënat kategoriale të bazës p.sh. folje F
- kuptimi: ‘X’

Të gjitha këto tipare jepen si për bazën, si për fjalën e derivuar. Po marrim një shembull: përsëri njësi të cilat tradicionalisht janë formuar me parashtesën [*për-*], për të parë edhe ndryshimin skematik e jo vetëm, nga modeli me bazë morfemën, që sqaruar pak më lart.

Rregulla fjalëformuese e [*përpuno*] me morfologjinë me bazë fjalën (word- based morphology) do të ishte:



Skemat e mësipërme dallohen lehtësisht nga ato paraprirëse, pasi në analizë merren fjalë të plota si konstituente me vlera semantike e kategoriale të caktuara, në ndryshim nga skemat e para ku dallohet procesi si identifikim i ngjitjes së morfemave, pavarësisht se këto të fundit karakterizoheshin edhe semantikisht, edhe nga pikëpamja kategoriale.

Natyrisht që skemat e fundit që paraqesin (word-based morphology) duken më të detajuara dhe janë brenda kuadrit gjenerativ (i cili pasqyron marrëdhëniet mes konstituenteve).

Sipas Plag-ut “Ajo që është analizuar si morfemë në morfologjinë me në bazë morfemën është pjesë e përshkrimit semantik e fonologjik në modelin me në bazë fjalën (word-based model)”. (Plag, 2002:238).

Përparësia e një paraqitjeje të tillë (word-based model) është fakti se ky lloj modeli i përfshin të dyja si derivimin me afikse, ashtu edhe atë pa afikse (që nuk i përfshinte modeli

tjetër, raste të tilla, si: konversioni, shkurtime, fshirjet, shkrirjet [Plag, 2002:239]).

Nga ana tjetër, edhe ky model ka pasur vërejtjet e veta që lidhen me të ashtuquajturin fjalëformim prapavajtës. Po kështu, edhe në lidhje me konversionin, pasi nuk përcaktohet drejtimi sa produktiv është në të dyja kahet.

Modeli me bazë fjalën (word-based model) kamuflon deri diku dominancën fjalëformuese të kokave afikse, pasi ato dalin në kuadrin e fjalës.

Gjithsesi Plag sugjeron se të dy modelet janë të rekomandueshme të përdoren, pasi elementet që nuk i përfshin njëra, i pasqyron tjetra. (Plag, 2002:244)

### **Përfundime**

Në përfundim të këtij punimi mund të themi se në kontekstin që ndodhen studimet tona mbi fjalëformimin shihet nga ne si domosdoshmëri:

1. Futja e konceptit të kokës, pasi, sipas nesh, ai i jep përmasa dhe rëndësi me vlerë polidimensionale afikseve dhe temave fjalëformuese tradicionale.

2. Rikonceptimi i pasurive semantike dhe kategoriale edhe në lidhje me një njësi të vetme fjalëformuese, në varësi të të dhënave që dalin nga aplikimi i termit *kokë*.

3. Përshkrimi i këtyre pasurive, pasi një gjë e tillë bën të mundur identifikimin edhe të kufizimeve të kokave të caktuara në lidhje me morfemat, me të cilat lidhen për të formuar fjalën komplekse.

4. Studimi paraprak i pikave më lart duhet të përbëjë korpusin referues të analizës, në mënyrë që të hartohet një manual, në të cilin të përshkruhen rregullat fjalëformuese, që ofron leksikoni i shqipes.

5. Tipologjia e rregullave fjalëformuese sugjerohet që të ketë modelin me bazë fjalën e gërshetuar ose në marrëdhënie me rezultatet empirike të modelit me bazë morfemën.

**BIBLIOGRAFI**

- Akcema, P. (1984). *Issues in Morphosyntax*. Amsterdam. J.Benjamins PC. Yearbook of morphology. 1988. Holland. Foris publications.
- Anderson, J. (1980). "Towards dependency morphology: the structure of the Basque verb. que verb". In Anderson, J. & Ewen, C. J., (eds) *Studies in dependency phonology*, Ludwigsburg. 227-271.
- Anderson, J. & Ewen, C. (1987). *Principles of dependency phonology*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Aronoff, M. (1976). *Word Formation in Generative Grammar*. Cambridge. Mitt. Press.
- Bauer, L. (1983). *English word-formation*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Bauer, L. (1988). *A descriptive gap in morphology*. Yearbook of Morphology I. 17-27.
- Bauer, L. (1990). *Be-Heading the Word*. Journal of Linguistics. Vol. 26. No. 1. pp. 1-31.
- Bloomfield, L. (1935). *Language*. London: Allen & Unwin.
- Baker, M. (1988). *Incorporation*. Chicago: University of Chicago Press.
- Cruse, D. A. (1986). *Lexical semantics*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Chomsky, N. (1970). *Remarks on nominalization*. In Jacobs, R. & Rosenbaum, P. (eds) *Readings in English transformational grammar*, Waltham, Mass.: Ginn. 184-221.
- Demiraj, Sh. 1967, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë.
- Di Sciullo, A.M.&Williams, E. (1987). *On the Definition of Word*. MIT Press. Cambridge.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 2002, Tiranë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Hudson, R. A. (1980). *Constituency and dependency*. Linguistics.
- Hudson, R. A. (1987). *Zwicky on heads*. JL 23.

- Hysa, E. (2004). *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Kostallari, A. (1961). *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*. Nr. 3.
- Kostallari, A. (1962). *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*. Nr. 3.
- Kostallari, A. (1976). *Studime filologjike*. Nr. 2.
- Lieber, R. (1981). *On the organization of the lexicon*. Indiana University Linguistics Club.
- Lyons, J. (1977). *Semantics*. Cambridge: Cambridge University Press.
- MC Carthy, A. C. (1992). *Current morphology*. London. Routledge.
- Plag, I. (2002). *Word formation*. Cambridge University Press.
- Robinson, J. J. (1970). *Dependency structure and transformational rules*. Lg 46. 259-285.
- Studime gjuhësore*. (1987) Prishtinë, Rilindja.
- Scalise, S. (1994). *Morfologia*. Bologna. Il Mulino.
- Selkirk, E. (1982). *The syntax of words*. Cambridge, Mass.: MIT Press.
- Thomai, J. (1983). *Studime filologjike*. Nr. 3.
- Thomai, J. (1989). *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*. Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Williams, E. (1981). *On the notion lexically related and head of a word*. *Linguistic inquiry*. MIT Press.
- Williams, E. (1981). *Argument structure and morphology*. *The Linguistic Review* I. 81-i 114
- Zwicky, A. M. (1985). *Heads*. JL 21. 1-29.

